



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit
P-008

Prishtinë, më 15 mars 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 15 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 mars 2011,
2. Kërkesa e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për emërimin e auditorit të jashtëm për auditim të pasqyrave vjetore financiare,
3. Kërkesa e z. Kolë Berisha dhe z. Nexhat Dacit lidhur me përfitimet për ish zyrtarë të lartë,
4. Kërkesa e Avokatit të Popullit për shpalljen e konkursit për pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit,
5. Kërkesa e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë për caktimin e tre deputetëve si anëtarë të Komisionit të ngritur lidhur me rishikimin dhe hetimin e të gjitha aktvendimeve të marra nga Paneli për lirim me kusht nga data 16 tetor 2010 deri më 22 shkurt 2011,
6. Raporti i Punës së Agjencisë së Prokurimit Publik të Kosovës, për vitin 2010,
7. Raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010,
8. Propozim- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave,
9. Propozimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me propozimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
10. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 mars 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8 mars 2011.

2. Kërkesa e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për emërimin e auditorit të jashtëm për auditim të pasqyrave vjetore financiare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bashkërenditje me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, t'i marrë veprimet e nevojshme për shpalljen e njoftimit për kontratë lidhur me emërimin e Auditorit të Jashtëm për auditim të pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

3. Kërkesa e z. Kolë Berisha dhe z. Nexhat Dacit lidhur me përfitimet për ish zyrtarë të lartë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të Ligjit për përfitimet e ish- zyrtarëve të lartë, të jep një interpretim-sqarim lidhur me kërkesat e ish-kryetarëve të Kuvendit, z. Nexhat Daci dhe z. Kolë Berisha.

4. Kërkesa e Avokatit të Popullit për shpalljen e konkursit për pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që:

1. T'i hartojë rregullat procedurale për zgjedhjen dhe emërimin e pesë (5) zëvendësavokatëve të popullit, në pajtim me nenin 8.14 të Ligjit për Avokatin e Popullit.
2. Ta shqyrtojë kërkesën e Avokatit të Popullit për zgjedhjen dhe emërimin e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

5. Kërkesa e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë për caktimin e tre deputetëve si anëtarë të Komisionit të ngritur lidhur me rishikimin dhe hetimin e të gjitha aktvendimeve të marra nga Paneli për lirim me kusht nga data 16 tetor 2010 deri më 22 shkurt 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë për caktimin e tre deputetëve si anëtarë të Komisionit të ngritur lidhur me rishikimin dhe hetimin e të gjitha aktvendimeve të marra nga Paneli për lirim me kusht nga data 16 tetor 2010 deri më 22 shkurt 2011, me arsyetimin se deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk mund të jenë anëtarë të komisioni të krijuar nga dega e ekzekutivit.

6. Raporti i Punës së Agjencisë së Prokurimit Publik të Kosovës, për vitin 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Raportin e Punës së Agjencisë së Prokurimit Publik të Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

7. Raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2010, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

8. Propozim- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim - Vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

9. Propozimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me propozimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me propozimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

10. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare që do të mbahet më 25 mars 2011, dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision i përhershëm, që ta shqyrtojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.